
HOLLËSI TË TJERA LIDHUR ME ZGJIDHJEN E MOSPAJTIMEVE

Për ekzemplarë të kësaj fletushke në gjuhët e komuniteteve si dhe për hollësi të tjera lidhur me Shërbimin për Zgjidhjen e Mospajttimeve pranë SEN në Londër, përfshirë këtu edhe videot dhe materialet tjera për aftësim, ju lutemi vizitoni websajtin tonë në adresën: www.londonsenmediation.org.uk

Shërbimi për Zgjidhjen e Mospajttimeve pranë SEN në Londër këtë fletushkë e ofron edhe si audio-kasetë, në alfabetin Braille për të verbërit si dhe me shkronja më të mëdha.

SI TË NA KONTAKTONI

Nëse dëshironi hollësi të tjera lidhur me Shërbimin për Zgjidhjen e Mospajttimeve pranë SEN në Londër, ose nëse dëshironi të bëni një referim, ju lutemi kontaktoni me:

Annette Colleary ose Jo Scherer-Thompson
Drejtues të Shërbimit

The London SEN Disagreement Resolution Service
240 Lancaster Road, London W11 4AH

Tel: 0800 389 0695 **Telefaksi:** 020 7243 8512
E-maili: acolleary@kids-online.org.uk or
jos@kids-online.org.uk



SEN LONDËR

SHËRBIMI PËR ZGJIDHJEN E MOSPAJTIMEVE

KUSH JEMI NE?

Shërbimi për Zgjidhjen e Mospajtimeve pranë SEN në Londër (LDRS) është shërbim që synon të zgjidh konflikte që lindin në mes të prindërve dhe LEA-ve/shkollave lidhur me nevojat e posaçme në shkollim të fëmijëve dhe rreth asaj se si të plotësohen këto më së miri. Ky shërbim drejtohet nga KIDS, organizatë kjo e pavarur bëmirese me mbi tridhjetë vite përvojë në punën me fëmijë që kanë nevoja të posaçme dhe me familjet e tyre.

ÇFARË OFROJMË?

Shërbimi ynë bazohet në parimin e ndërmjetësimit. Ndërmjetësimi është proces jozyrtar dhe vullnetar i cili përfshin një palë të tretë të pavarur (ndërmjetësuesin) i cili u ndihmon palëve në konflikt të gjejnë zgjidhje të pranueshme për të gjithë. Ndërmjetësuesi është i paanshëm, nuk i mban krah askujt dhe nuk u parashtron palëve propozime ose zgjidhje të mundshme. Ndërmjetësuesi kontrollon procesin por jo përfundimin e ndërmjetësimit. Janë palët vetë ato që gjejnë zgjidhje / vendosin përfundimin me pjesëmarrjen e tyre në procesin e ndërmjetësimit.

KUSH JANË NDËRMJETËSUESIT?

LDRS ka bordin e vet të ndërmjetësuesëve të pavarur dhe me përvojë. Të gjithë këta janë aftësuar në ndërmjetësim dhe në praktikën dhe çështjet ligjore që kanë të bëjnë me nevojat e posaçme në shkollim (SEN)

KU ZHVILLOHEN BISEDIMET?

LDRS do të kërkojë nga Autoritetet Lokale të Shkollimit (LEA) ose nga shkolla e përfshirë në mospajtim të sigurojnë një vend të përshtatshëm për seancën e bisedimeve. Dy ose tri dhoma janë të nevojshme në mënyrë që ndërmjetësuesi të bisedojë privatisht me secilën nga palët sipas nevojës gjatë rrjedhës së bisedimeve.

Prindërit shpesh kanë dëshirë të bisedojnë në zyrat e LEA por ndonjëherë është më mirë që takimet të mbahen në një vendtakim neutral. Nga LEA ose nga shkolla e përfshirë do të kërkohet të sigurojnë pijet freksuese dhe të gjejnë lokale të përshtatshme për drekë.

ÇFARË NDODHË NËSE ARRIHET MARRËVESHJA?

Nëse nëpërmjet bisedimeve arrihet marrëveshja në të gjitha ose në disa nga çështjet e diskutuara, para përfundimit të seancës ndërmjetësuesi do ta përgatisë dokumentin e marrëveshjes. Për formulimin e tij do të konsultohen palët. Nëse të gjithë janë të kënaqur me marrëveshjen, do të kërkohet nga palët ta nënshkruajnë atë dhe të gjithë palëve të pranishme do t'u jepet nga një kopje. Ndërmjetësuesi gjithashtu i dërgon nga një kopje të marrëveshjes LDRS me qëllim të mbikëqyrjes së cilësisë.

MBIKËQYRJA E CILËSISË NË LDRS

Nga pjesëmarrësit në bisedime do të kërkohet t'i plotësojnë pyetësorët dhe t'ia dërgojnë ato të mbyllura në zarfë LDRS. Vlerësimi i shërbimit nëpërmjet pyetësorëve nga ana e pjesëmarrësve paraqet formën kryesore të mbikëqyrjes së cilësisë. Herë pas here dhe me lejen e palëve të përfshira, Drejtuesit e Shërbimit të LDRS-së do ta vlerësojnë poashtu edhe efektshmërinë e ndërmjetësuesëve.

KUSH MERR PJESË NË BISEDIME?

Prindërit/Përkujdesësit duhet të marrin pjesë në ndërmjetësim dhe kanë të drejtë ta zgjidhin mospajtimin. Prindërit/Përkujdesësit inkurajohen të marrin me vete ndonjë ndihmës në sesionet e bisedimeve. Ky mund të jetë Nëpunësi i Partneritetit për Prindër, ndonjë mik ose ndonjë i afërm.

Përfaqësuesi i LEA Është qenësore që përfaqësuesi i LEA i pranishëm në bisedime të jetë i autorizuar të zgjidh mospajtimin. Kjo do të thotë që nëpunësi që përfaqëson LEA është i autorizuar të arrijë marrëveshje në çështjet e shtruara në seancë pa u këshilluar me kolegët e tij të vjetër ose me bordin drejtues.

Përfaqësuesi i shkollës Në shumicën e rasteve mospajtimet ndodhin në mes prindërve/përkujdesësve dhe LEA, prandaj është e drejtë e LEA të gjejë një zgjidhje ose të ndërmarrë masa të duhura. Mirëpo shumë nga çështjet ku përfshihet SEN janë të tilla ku edhe shkolla luan një rol vendimtar. Prandaj është e rëndësishme që, në rast nevoje, shkolla, e në veçanti Kryemësuesit dhe SENCO të jenë të ftuar të marrin pjesë në zgjidhjen e mospajtimin.

Përfaqësuesit e shkollës luajnë role të ndryshme në seancat e bisedimeve meqë këta mund të jenë të ftuar nga ana e prindërve ose nga ana e LEA. Roli i përfaqësuesëve të shkollës do të qartësohet para bisedimeve. Përfaqësuesit e shkollës do të mund të bisedojnë shtruar me LDRS në lidhje me atë se çfarë përfundimi mund të presin nga bisedimet dhe si të përgatiten më së miri.

Shënim: meqë bisedimet nuk paraqesin proces zyrtar, palët nuk mund të sjellin me vete përfaqësuesë ligjor

SI FUNSKIONON NDËRMJETËSIMI MË SË MIRI?

Gjatë vendimmarrjes lidhur me pjesëmarrjen në bisedime, LEA gjegjësisht shkolla dhe prindërit/përkujdesësit është mirë të kenë parasysh nëse ekziston mundësia për marrëveshje lidhur me cilëndo prej çështjeve që ka shkaktuar mospajtimin. Është qenësore që të gjitha palët të vijnë në bisedime me dëshirë të vërtetë për ta zgjidhur mospajtimin dhe me gatishmëri për të ardhur te marrëveshja.

SI BËHET REFERIMI?

Referimet për bisedime mund të vijnë nga LEA, shkolla, prindërit ose nga Shërbimi i Partneritetit për Prindër. Në rast të referimeve prindërore është e rëndësishme që prindërit të kenë kërkuar këshilla dhe mbështetje para se ta sjellin çështjen në LDRS. Prandaj preferohet që referimet prindërore të kalojnë nëpër Shërbimin e Partneritetit për Prindër. Nëse shkolla beson që mbajtja e bisedimeve është e dobishme, ajo mund të drejtohet për udhëzime drejtpërdrejtë te LDRS ose te LEA.

A MBAHEN NË FSHEHTËSI SEANCAT E BISEDIMEVE?

Përveç nëse palët merren vesh ndryshe, përmbajtja e seancës së bisedimeve mbetet e fshehtë dhe zhvillohet pa paragjykuar çfarëdo masash të Gjykatës SEN. Dokumentet e vetme publike që rrjedhin nga seanca e bisedimeve janë ato të marrëveshjes ndërmjet palëve në bisedime. Përrjashtimi i vetëm nga rregulla e sipërme e fshehtësisë janë rastet nëse del në pah ndonjë çështje që ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve.

PROÇESI I REFERIMIT

REFERIMET MUND TË BËHEN ME TELEFON, E-MAIL OSE ME SHKRIM

Nëse referimi bëhet nga një nëpunës i LEA, nga nëpunësi i Partneritetit për Prindër (Parent Partnership) ose nga shkolla, do të kërkohet konfirmimi për t'u siguruar që të gjitha palët pajtohen të marrin pjesë në bisedime.

Nëse referimi bëhet nga ana e një prindi, LEA do t'i dërgohet një letër standarde për t'i ftuar të marrin pjesë në bisedime.

Nëse LEA e refuzon pjesëmarrjen, shërbimi do ta njoftojë prindin që bisedimet nuk zhvillohen.

Nëse të gjitha palët janë të pajtimit të marrin pjesë në bisedime

Shërbimi për Zgjidhjen e Mospajtimeve pranë SEN në Londër (LDRS) mbikëqyr që pjesëmarrësit të jenë të autorizuar të vendosin lidhur me zgjidhjen e konfliktit dhe gjithashtu kujdeset për të siguruar hollësitë e mospajtit nga këndvështrimi i të gjitha palëve. Nëse ndonjëra nga palët nuk është e autorizuar në masë të mjaftueshme, LDRS-ja mund të mos e organizojë ndërmjetësimin.

LDRS përgatit dokumentacionin për të gjitha palët duke i ekspozuar pikat të cilat ata i kanë përshkruar si sfera kryesore të mospajtit.

LDRS ua dërgon këtë dokumentacion të gjitha palëve për arsye përpikshmërie. Nga të gjitha palët do të kërkohet të nënshkruajnë nga një kopje dhe ta kthejnë këtë në zarfën e stampuar dhe të adresuar e cila do të jetë e bashkangjitur. Kur të pranohet miratimi, kopjet e dokumentacionit do t'u dërgohen palëve pjesëmarrëse.

Nga LEA do të kërkohet të përkujdeset për një vendtakim të përshtatshëm dhe ta njoftojë LDRS lidhur me hollësitë, vendin dhe udhëzimet për udhëtim. Këto të dhëna u dërgohen të gjitha palëve, bashkë me emrin e ndërmjetësuesit dhe bashkë me disa hollësi të përmbledhura lidhur me të.

Bisedimet zhvillohen

Nëse vjen deri te marrëveshja, kjo shënohet në letër dhe një kopje e saj u jepet të gjitha palëve. Një kopje tjetër ndërmjetësuesi ia dërgon LDRS.

Si pjesë e mbikqyrjes së cilësisë, nga pjesëmarrësit do të kërkohet poashtu t'i plotësojnë pyetësorët dhe t'i dërgojnë ato të mbyllura në zarfë në LDRS.